



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-10

**Prokurorja e Specializuar k. Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit
dhe Haxhi Shalës**

Vendosi: Trupi Gjykues I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 16 janar 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër për Dorëzim të Materialit Provues

T'i njoftohet:

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Sabit Januzit
Xhonatan Elistan Ris

Mbrojtjes së Ismet Bahtijarit
Felisiti Geri

Mbrojtjes së Haxhi Shalës
Tobi Kadman

TRUPI GJYKUES I (Trupi gjykues) lëshon këtë urdhër për dorëzimin e materialit provues.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 13 nëntor 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) informoi Trupin Gjykues se kishte lidhur marrëveshje për pranimin e fajësisë me Haxhi Shalën (z. Shala), Sabit Januzin (z. Januzi) dhe Ismet Bahtijarin (z. Bahtijari) (bashkërisht, të akuzuarit) dhe ia bëri të njohura marrëveshjet e lartpërmendura Trupit Gjykues.¹

2. Më 6 dhjetor 2024, në pajtim me vendimin e Trupit Gjykues,² ZPS-ja dorëzoi: (i) versionet e rishikuara të secilës marrëveshje për pranimin e fajësisë; (ii) parashtrime mbi marrëveshjet në fjalë dhe mbi dënimin; dhe (iii) një aktakuzë të rishikuar.³ Po atë ditë, Mbrojtja e z. Shala,⁴ Mbrojtja e z. Januzi⁵ dhe Mbrojtja e z. Bahtijari⁶ dorëzuan parashtrimet e tyre përkatëse, ku trajtonin çështjet e lidhura me dënimin dhe jepenin informacione dhe/ose prova në lidhje me to.

¹ KSC-BC-2023-10, F00596, Prokurorja e Specializuar, *Njoftim Urgjent nga Prokuroria i Marrëveshjeve për Pranimin e Fajësisë*, 13 nëntor 2024, konfidencial, me Shtojcat 1-3, konfidenciale. Versionet e korrigjuara të parashtrimit përcjellës dhe të shtojcave u dorëzuan më 14 nëntor 2024, F00596/COR, F00596/COR/A01, F00596/COR/A02, F00596/COR/A03.

² KSC-BC-2023-10, F00612, Trupi Gjykues I, *Vendim mbi Çështje të Lidhura me Procedurën për Pranimin e Fajësisë*, 29 nëntor 2024, konfidencial, para. 20-23, 27, 34(a)-(c) me Shtojcën 1, konfidenciale dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2023-10, F00618, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime Urgjente të Prokurorisë mbi Marrëveshjet për Pranimin e Fajësisë dhe Dënimin*, 6 dhjetor 2024, konfidenciale, me Shtojcat 1-2, publike (përmbajnë, përkatësisht, Marrëveshjen për Pranimin e Fajësisë me Shalën dhe Marrëveshjen për Pranimin e Fajësisë me Januzin) dhe Shtojcën 3, konfidenciale; F00619, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim Urgjent i Aktakuzës së Rishikuar me Shtojcën Konfidenciale 1*, 6 dhjetor 2024, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale.

⁴ KSC-BC-2023-10, F00616, Mbrojtja e Shalës, *Parashtrime me Shkrim në lidhje me Dënimin*, 6 dhjetor 2024, konfidenciale, me Shtojcat 1-4, konfidenciale.

⁵ KSC-BC-2023-10, F00617, Mbrojtja e Januzit, *Parashtrime të Januzit në lidhje me Dënimin në bazë të Marrëveshjes për Pranimin e Fajësisë*, 6 dhjetor 2024, konfidenciale.

⁶ KSC-BC-2023-10, F00620, Mbrojtja e Bahtijarit, *Parashtrime të Bahtijarit në lidhje me Dënimin*, 6 dhjetor 2024, konfidenciale, me Shtojcat 1-3, konfidenciale. Një version i korrigjuar u dorëzua më 11 dhjetor 2024, F00620/COR.

3. Më 16 dhjetor 2024, ZPS-ja informoi Trupin Gjykses se kishte lidhur një marrëveshje të re për pranimin e fajësisë me z. Bahtijari dhe ia bëri të njohur marrëveshjen në fjalë Trupit Gjykses.⁷

4. Më 17 dhjetor 2024, ZPS-ja dorëzoi një aktakuzë të rishikuar më tej.⁸

5. Më 18 dhe 19 dhjetor 2024, Trupi Gjykses mbajti seanca mbi marrëveshjet për pranimin e fajësisë.⁹

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Trupi Gjykses mbështetet në nenin 40(2) të Ligjit nr. 05/L053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe në rregullat 9(5)(a) dhe 94 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).

III. ANALIZA

7. Trupi Gjykses rikujton se mund të miratojë marrëveshje për pranimin e fajësisë, në qoftë se bindet, ndër të tjera, se ekziston bazë faktike e mjaftueshme që konfirmon faktet thelbësore të nevojshme për vërtetimin e veprave penale dhe pjesëmarrjen e të akuzuarve në to, siç përcaktohet në rregullën 94(5)(e) të Rregullores. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses vëren bazën faktike për të cilën palët pajtohen, siç përshkruhet në

⁷ KSC-BC-2023-10, F00628, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim Urgjent i Përbashkët i Marrëveshjes për Pranimin e Fajësisë*, 16 dhjetor 2024, konfidencial, me Shtojcën 1, publike (përmban Marrëveshjen e Pranimit të Fajësisë me Bahtijarin).

⁸ KSC-BC-2023-10, F00630, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Rishikuar më Tej*, 17 dhjetor 2024, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale.

⁹ KSC-BC-2023-10, Transkripti i seancës, 18 dhjetor 2024, konfidencial, f. 378-532; Transkripti i seancës, 19 dhjetor 2024, konfidencial, f. 533-604.

secilën marrëveshje për pranimin e fajësisë.¹⁰ Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se, sipas marrëveshjeve për pranimin e fajësisë, në qoftë se ZPS-ja do të vijonte me paraqitjen e provave, faktet dhe pretendimet e përfshira në Aktakuzën e Konfirmuar të datës 10 korrik 2024, që pasqyrojnë bazën faktike për të cilën palët pajtohen, do të vërtetoheshin përtej dyshimit të arsyeshëm.¹¹

8. Për të konstatuar nëse përmbushet kriteri i rregullës 94(5)(e) të Rregullores, Trupi Gjykses e sheh të nevojshme të shqyrtojë nëse baza faktike për të cilën palët pajtohen mbështetet edhe nga provat.¹² Për këtë qëllim, Trupi Gjykses i urdhëron palët të dorëzojnë, bashkërisht ose veçmas, materialin provues që e gjykojnë të nevojshëm për vlerësimin e Trupit Gjykses në bazë të rregullës 94(5)(e) të Rregullores, si edhe parashtime përse provat në fjalë janë të nevojshme për këtë, jo më vonë se **të premten, 24 janar 2025, ora 16:00**. Provat e lartpërmendura duhet t'u bashkëlidhen si shtojcë (shtojca) parashtimeve me shkrim të palëve. Gjithashtu, për të siguruar një vijim të shpejtë të procedurës, Trupi Gjykses e konsideron të përshtatshëm shkurtimin e afateve për përgjigjet dhe kundërpërgjigjet e palëve, sipas rregullës 9(5)(a) të Rregullores. Në përputhje me këtë, palët të dorëzojnë përgjigjet, në qoftë se dëshirojnë, jo më vonë se **të enjten, 30 janar 2025, ora 16:00**. Kundërpërgjigjet, nëse do të ketë, të dorëzohen jo vonë se **të hënë, 3 shkurt 2025, ora 16:00**.

9. Trupi Gjykses e sheh me rëndësi të theksojë se materiali provues i propozuar do të merret në shqyrtim *vetëm* në funksion të konstatimit nëse baza faktike e miratuar dhe e kufizuar nga ZPS-ja dhe secili i akuzuar në marrëveshjet për pranimin e fajësisë, mbështetet edhe nga provat.

¹⁰ *Shih* Marrëveshjen për Pranimin e Fajësisë me Shalën, f. 12; Marrëveshjen për Pranimin e Fajësisë me Januzin, f. 12; Marrëveshjen për Pranimin e Fajësisë me Bahtijarin, f. 12.

¹¹ *Shih* Marrëveshjen për Pranimin e Fajësisë me Shalën, para. 5; Marrëveshjen për Pranimin e Fajësisë me Januzin, para. 5; Marrëveshjen për Pranimin e Fajësisë me Bahtijarin, para. 5.

¹² *Ngjashëm*, ICTY, *Prosecutor v. Ranko Češić*, IT-95-10/1-S, Trial Chamber I, Sentencing Judgement, 11 March 2004, para. 5, 14; *Prosecutor v. Momir Nikolić*, IT-02-60/1-S, Trial Chamber I, Sentencing Judgement, 2 December 2003, para. 52.

IV. VENDIMI

10. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues:

- a. **URDHËRON** palët të dorëzojnë materialin provues të cilin e konsiderojnë të nevojshëm për vlerësimin e Trupit Gjykues në bazë të rregullës 94(5)(e) të Rregullores, si edhe argumente përse provat në fjalë janë të nevojshme, jo më vonë se **të premten, 24 janar 2025, ora 16:00**, në përputhje me udhëzimet e Trupit Gjykues në paragrafin 8;
- b. **URDHËRON** palët të dorëzojnë përgjigje, nëse dëshirojnë, jo më vonë se **të enjten, 30 janar 2025, ora 16:00** dhe kundërpërgjigje, nëse do të ketë, jo më vonë se **të hënë, 3 shkurt 2025 ora 16:00**; dhe
- c. **UDHËZON** palët të informojnë Trupin Gjykues me postë elektronike në qoftë se nuk synojnë të dorëzojnë parashtrime, përgjigje dhe/ose kundërpërgjigje.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse

/nënshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E enjte, 16 janar 2025

Hagë, Holandë.